



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 16- 43265 / 15
Kaçanik, 28.12. 2015

R R E G U L L O R E

**PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01Nr. 16-3317/15 TË DATËS
30.01.2015-PËR PAGESËN E TARIFAVE, NGARKESAVE ADMINISTRATIVE,
GJOBAVE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE**

Dhjetor , 2015

Në bazë të nenit, 5 lidhur më nenet, 12.1. 12.2(c), 40.2(a, g) dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-048- Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 dhe 8. të Ligjit Nr 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 34.5. të Statutit të Komunës si dhe nenit 15.1(f) të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 dhjetor 2015, aprovoj ;

RREGULLORE

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01Nr. 16-3317/15 TË DATËS 30.01.2015- PËR PAGESËN E TARIFAVE, NGARKESAVE ADMINISTRATIVE, GJOBAVE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja 01Nr. 16-3317/2015-Për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale, e datës 30.01.2015.

Neni 2

Ndryshimet dhe Plotësimet

2.1. Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale, bëhen të Pjesa 4 të Tarifat dhe Ngarkesat për Ndërtim dhe Urbanizëm, si vijon:

2.1.1. Të neni 9 shtohet Pika **9.1.11**. Për pjesëmarrjen e lejes së ndërtimit për fabrikat për prodhimin e betonit-betonierat dhe atë, tarifa **10€ për m³** të rezervarëve të vendosur për prodhim të betonit.

Neni 3
Përgjegjës për zbatim

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje, do të kujdeset, Kryetari i Komunës, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

[Handwritten signature]